



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim 2

Ngarkesa: 4 kredite (= 40 orë mësimore); 4 Kredite seminar (= 40 orë mësimore)

Viti / Semestri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Gjuhë Angleze

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të thellojë aftësitë e studentëve në analizën dhe përkthimin e teksteve komplekse në gjuhën shqipe dhe në anglisht, duke marrë në konsideratë aspektet gjuhësore, stilistike dhe kulturore. Të trajtojë përkthimin si proces dhe si produkt, në nivele mikro dhe makro të analizës së tekstit. Të lidhë përkthimin me fusha të tjera si media, studimet kulturore dhe komunikimi ndërkulturor.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të trajtojë në mënyrë teorike dhe praktike dukuritë gramatikore, leksikore dhe stilistike në anglisht dhe në shqip në kontekst përkthimor.
2. Të zhvillojë teknika për trajtimin e teksteve të stileve të ndryshme funksionale, veçanërisht të mediave, përmes integritetit të njohurive ndërdisiplinore.
3. Të përgatisë studentët për të aplikuar strategji efektive për analizimin dhe zgjidhjen e problemeve që hasen gjatë përkthimit të teksteve autentike.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të manipulojnë dhe përkthejnë tekste të regjistrave dhe stileve të ndryshme, sidomos në fushën e medias.
2. Do të zotërojnë teknika për të identifikuar dhe zgjidhur probleme përkthimore me burim në struktura gjuhësore, leksikore dhe stilistike.
3. Do të kenë zhvilluar kompetenca të avancuara për të ndërthurur përkthimin me njohuritë e përftuara nga disiplina të tjera, duke arritur një kuptim të thellë të rolit të përkthimit në komunikimin ndërkulturor dhe profesional.